

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Albert Zogaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit J.B. nga Gjilani, kundër të paditurës, Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim të cilën e përfaqëson i autorizuari B.D., për shkak të shpërblimit të pagave jubilarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.318/2014, të datës 07.07.2014, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 16.10.2017 mori këtë;

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET ankesa e të autorizuarit të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.318/2014, të datës 07.07.2014, në pikën I të dispozitivit ashtu që REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit J.B. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj shumën prej 308.85€, me kamatë prej 3.5%, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së pranimit të aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, SIE PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit J.B. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim dhe detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave prej 308.85€, në emër të shpërblimit jubilar, me kamatë vjetore prej 3.5% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 06.10.2011, e deri në përmbushjen definitive të obligimeve të krijuara. Me pikën II (dy) të dispozitivit detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim që paditësit J.B., në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj shumën e të hollave 15€. Në pikën III (tre) të dispozitivit detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim që kësaj gjykate t'ia paguajë taksën gjyqësore për aktgjykim, në vlerë prej 15€.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurës për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet ashtu që

kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar, ose i njëjti të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi me propozim që ankesa e të autorizuarit të paditurës të refuzohet në tërësi si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 dhe 201 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi J.B. nga Gjilani me datën 06.10.2011, ka parashtruar padi për kompensimin e pagave me të cilën kërkuar që të obligohet ta obligohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, që paditësit t'ia paguajë në emër të shpërblimit jubilar në shumën e mjeteve monetare prej 308.85€, me kamatë prej 3.5% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë e deri në përmbushjen definitive të obligimeve të krijuara si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, me qëllim të vlerësimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datën 07.07.2014, kërkesa nr.06-394-8985, e datës 21.06.2011, plotësimi i kërkesës e datës 26.09.2011, konkluzioni nr.06-16-8985, i datës 06.09.2011, i lëshuar nga Komuna e Gjilanit, kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e konkluzionit nr.02-16-37708, e datës 19.09.2011, vërtetimin nr.02-16-38992, i datës 21.09.2011 i lëshuar nga Komuna e Gjilanit, vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës nr.02-16-4695, i datës 05.04.2011, vërtetimi nr.02-16-19064, i datës 21.02.2012 i lëshuar nga Komuna e Gjilanit, librezë e punës me numër të serisë ..., vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 29.01.2013.

Pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore së paditësi ka qenë në marrëdhënie punë tek e paditura, i cili për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension. E paditura nuk e ka kundërshtuar pretendimin e paditësit se tek e paditura ka punuar në një periudhë mbi 27 vjet.

Për lartësinë e pagave të aprovuara gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë pagën që ka marr paditësi në bazë të kontratës në tre muajt e fundit, e cila për një muaj ka qenë në shumë prej 308.85 Euro.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës, përcaktohet se Kontrata Kolektive hyn në fuqi me datën 01.01.2005 dhe me asnjë dispozitë tjetër nuk e përcakton kohën e validitetit të saj.

Gjykata ka vlerësuar së Kontrata Kolektive zbatohet edhe për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, ashtu që në bazë të nenit 50 të Kontratës Kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të një

page bazë, ndërsa për 30 vite të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar. Në neni 51 të Kontratës Kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesën përcjellëse në lartësi të dy pagave minimale mujore të punëtorit në Kosovë për tre muajt e fundit.

Gjykata e shkallës së dytë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 paragrafi 2 pika b), g), j),k) dhe m) të LPK-së, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështrojnë sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale dhe për këtë arsye aktgjykimi është dashur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar e në bazë të nenit 195 par.1 nën pikën e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 nën pikën d) të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar i Gjykatës Themelore në Gjiilan, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësi në emër të shpërblimit jubilar, është në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me zbatimin e gabuar të nenit 50 dhe 51 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, pasi që kjo kontratë ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2005 me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 01.01.2008, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik. Me skadimin e aftit të Kontratës Kolektive e njëjta nuk mund të aplikohet për rastet tjera pas datës 01.01.2008, e as për rastin e paditësit meqë padia është paraqit në gjykatë me datën 06.10.2011, ndërsa paditësi është pensionuar me datën 15.04.2011, pasi që ka pushuar së zbatuari Kontrata e Përgjithshme Kolektive.

Në kuptim të cekurave kjo gjykatë ka vendosur që ta aprovoi si të bazuar ankesën e të autorizuarit të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat Gjykata e Apelit kujdesit sipas detyrës zyrtare.

Vendimin për shpenzimet e procedurës kjo gjykatë e ka bazuar në dispozitën e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK, pasi që paditësit si palë e cila e ka humbur kontestin nuk i takojnë shpenzimet e kërkuara, ndërsa i autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimit kryesor shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, me çka edhe nuk i janë njohur nga ana e kësaj gjykate.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (e) e lidhur me nenin 201 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3839/2014 të datës 16.10.2017

Kryetare e Kolegjit,
Nora Billaca-Dula d.v